



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE
KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr. 231 prot

Tiranë, më 23/4/2026

VENDIM

Nr. 5 datë 23/4 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 23/4/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 23.4. 2026 vendosi:

1.Për projektvendimin “Për krijimin, funksionimin dhe administrimin e fondit të gjelbër në kuadër të zhvillimit të territorit dhe hapësirave publike”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Neni 4, pika 2, germa a, b, c, ç, të përcaktohet një standard i qartë, dhe proporcional në raport me impaktin, përfitimet e biznesit, në mënyrë që të shmangen pabarazitë sociale dhe në të drejta që mund të krijohen në raport me fitimin që siguron biznesi i ndërtimit me detyrimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari shërbimi në hapësirat publike që janë pa impakt të përhershëm;

Neni 6, pika 2, vjen në kundërshtim me nenin 19/pika 5 dhe nenin 24/pika 2 e VKM nr. 224 datë 01.04.2026, sipas të cilit parashikohet detyrimi i kontributit me një pemë për tavolinë dhe të sqarohet nëse kontributi është i domosdoshëm edhe për rastet e lejeve të shfrytëzimit të hapësirës publike, të cilat janë në kushte rinovimi të afatit dhe kontributi në pemë është dhënë me lëshimin e lejes për herë të parë;

Neni 6, pika 3, termi “karrigeve” të zëvendësohet me termin “tavolinave”

Neni 8, pika 1, të riformulohet “Institucionet publike në nivel qendror apo vendor, që kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen, ruajtjen apo administrimin e fondit pyjor” ...dhe të shtohet togfjalëshi “apo për nevoja të pyllëzimit” të fondit pyjor të dëmtuar, sipas legjislacionit për pyjet dhe kullotat;

Neni 9 “Zbatimi”, të riformulohet “Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe Ministria përgjegjëse për pyjet dhe strukturat qendrore përgjegjëse për ruajtjen, administrimin e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi”;

Të përcaktohet qartë cili është roli i bashkive në menaxhimin e fondit të gjelbër;

Të ndryshohet duke krijuar mundësinë që dhe për lejet e ndërtimit që të paguhet ekuivalenti në të holla.

2. Për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”, propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

Të sigurohet një ndarje e qartë e përgjegjësive dhe një mekanizëm efektiv koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe të shoqërohet me mekanizma të qartë koordinimi ndërinstytucional;

Të shoqërohet akti me:

- një plan kombëtar për mbështetjen e bashkive në investimet infrastrukturore
- programe trajnimi për administratën vendore
- programe ndërgjegjësimit për qytetarët dhe bizneset
- udhëzime teknike standarde për organizimin e grumbullimit të diferencuar

Të krijohen mekanizma mbështetjeje financiare për bashkitë ndërkohë që implementimi i këtij sistemi do të kërkojë investime të konsiderueshme;

Të qartësohet roli i AKEM si institucion mbështetës dhe zhvillues i tregut të riciklimit më mirë në raport me bashkitë dhe institucionet e tjera publike.

3. Për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve” propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

Të qartësohet roli i njësisë të qeverisjes vendore. Ligji nuk përcakton qartë kompetencat e bashkive dhe strukturave vendore të pyjeve, duke krijuar hapësirë për centralizim të vendimmarrjes;

Të krijohet një model bashkëmenaxhimi midis SHSHP dhe bashkive, ku administrimi i pyjeve brenda territorit bashkiak të mos realizohet pa marrëveshje me bashkitë, dhe ku bashkitë të ruajnë rol aktiv në planifikim dhe kontroll;

Të qartësohet statusi i strukturave ekzistuese vendore të pyjeve nëse ato do të integrohen në strukturën e re apo do të vazhdojnë të funksionojnë pranë bashkive, duke garantuar që kapacitetet aktuale si dhe të saktësohet me dispozitave të qarta për bashkëpunim të detyrueshëm ndërmjet SHSHP, bashkive dhe strukturave të emergjencave civile, përfshirë krijimin e komandave të përbashkëta në nivel lokal gjatë sezonit të zjarreve;

Neni 7. Fusha e Veprimtarisë, gërma (dh) mbi zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet: përveç gërmës (i), (tregtimi i lëndës drusore dhe produkteve jo-pyje) të mund të shtohen “Shërbimet e Ekosistemit dhe Turizmit” sepse vitet e fundit, vlerësimi ekonomik i pyjeve është zhvendosur drejt ruajtjes dhe argëtimit si: Ekoturizmi (kampingjet, ngjitja në mal, vëzhgimi i kafshëve) Turizmi- aktivitete pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore turistike e sportive . (Bazuar në nenin 23,24,25 të Ligjit 57/2020 “Për pyjet”i ndryshuar;

Neni 2, 5, 7 dhe 8 janë në kundërshtim me Ligjin 57/2020 “Per Pyjet”, pasi nuk ka një definim të qartë kush do të konsiderohet pasuri shtetërore pyjore, pasi në Ligjin 57/2020 i ndryshuar, neni 12/pika 2, parashikohen dy definicione ligjore mbi pronësinë shtetërore për pyjet, të cilat janë: “Fond Pyjor në pronësi/administrim të Ministrisë përgjegjëse për pyjet” (përfshihen pyjet në zonat e mbrojtura nën administrim të AKZM); “Fond Pyjor në pronësi/administrim të NJVV-ve (bashki);

- Mospërcaktimi i qartë i pasurisë pyjore që do të jetë në administrim/menaxhim të ndërmarrjes shtetërore të pyjeve, krijon përplasje lidhur me kompetencën ekskluzive të NJVV-ve për administrimin, menaxhimin e pasurive pyjore që ato kanë në përgjegjësi administrimi ose në pronësi sipas listave të inventarit të miratuara, kompetencë e cila u njihet këtyre të fundit sipas Ligjit 57/2020 “Për Pyjet” neni 12/pika 3/neni 12/pika b, neni 16/pika 1, si dhe neni 17 i të njëjtit ligj. Në Ligjin 10120/2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, parashikohen kompetencat e bashkive, për menaxhimin e administrimin e bimëve të kategorive të përcaktuara që bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosore në pronësi/administrim të bashkive;

Neni 3. duhen shtuar jo vetëm BMTE, dhe kreditet e karbonit, por shërbimet në ekosistem, përfshirë edhe elemente të Konventës së peizazheve, si dhe organet drejtuese (keshilli mbikqyrës) duhet të jenë më gjithëpërfshirëse, jo vetëm politike dhe statusi juridik (tregtar) rrezikon komercializimin e sektorit pa menduar për pasojat afatgjata mjedisore (psh në rast të kërkesave të larta në tregun lokal apo global për një produkt apo shërbim të caktuar mund të çojë në degradimin e tij;

Neni 5, Qëllimi, duhet shtuar ‘komercializimi dhe kontabilizimi i shërbimeve në ekosistem’

Neni 7 i projekt-ligjit, gërma (d), parashikon të drejtën e ndërmarrjes për “parandalimin dhe luftimin e zjarreve në pyje”, ndërkohe që është në misionin dhe fushën e përgjegjësisë së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, njësia përgjegjëse për inspektimin në pyje, mbrojtja dhe kontrolli nëpërmjet inspektimit dhe imponimit të sanksioneve administrative, me qëllim parandalimin e paligjshmërive në pyje, si dhe te fusha e veprimtarisë duhet shtuar edhe...

- mbrojtja e pyjeve nga semundjet dhe dëmtuesit;
- pershtatja ndaj ndryshimeve klimatike;

- Komercializimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, si dhe të ketë një protokoll të qartë se si do të financohen këto ndërhyrje dhe nëse do t'i paguajë ShShP-ja bashkitë për shërbimin e zjarrfikësve kur digjen pyjet në administrim të shoqërisë

Neni 8. Të përcaktohet një ndarje më e qartë se cilat asete pyjore do të mbeten nën administrimin e bashkisë (asete të regjistruara tashmë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në emër të bashkive) dhe cilat do t'i kalojnë shoqërisë. Pa një ndarje fizike dhe ligjore të qartë, do të kemi konflikte në terren për dhënien e lejeve të shfrytëzimit apo menaxhimin e kullotave;

Neni 11, të ketë në Këshillin Mbikëqyrës përfaqësues direkt të bashkive ose një rotacion mes kryetarëve të bashkive që kanë sipërfaqet më të mëdha pyjore;

Neni 12, Administratori, të qartësohet roli, detyrat dhe perzgjedhja e tij;

Neni 13, Plani i menaxhimit dhe biznesit të qartësohet se për çfarë njesie/sipërfaqeje, burimet e mbështetjes financiare për zbatimin e planit etj..., si dhe roli i pushtetit vendor këtu si përfaqësues i komuniteteve rurale nuk duket gjekundi;

Neni 14, të përfshihen Shërbimet e Ekosistemit dhe Turizmit kur dihet se vitet e fundit, vlerësimi ekonomik i pyjeve është zhvendosur drejt ruajtjes, argëtimit, agroturizmit, etj. (bazuar në nenet 23, 24 dhe 25 të Ligjit 57/2020 "Për pyjet"i ndryshuar, ku një pjesë e të ardhurave nga pyjet lokale të shkojnë në buxhetin e bashkisë ose që një përqindje e fitimit të ShShP;

Neni 15, Bashkëveprimi ndërinstitucional, të përcaktohet roli i MBZHR, si institucioni kryesor për politikën dhe mbështetjen e zhvillimit rural në vend, si dhe projektligji parashikon bashkëpunimin e ndërmarrjes shtetërore për pyjet me organe si; Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, NJVV-ve si dhe institucione akademike e shkencore, por në asnjë pikë të këtij neni nuk parashikon detyrimin e ndërmarrjes për bashkëpunim me IKMT si organi qendror me funksione kontrolli dhe inspektimi që ka për kompetencë garantimin e zbatimit të ligjeve sektoriale në fushën e mbrojtjes së pyjeve nga ndërhyrjet e paligjshme të çdo lloji;

Të qartësohet arkitektura e qeverisjes së organeve drejtuese sepse ekziston rreziku i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë politike në vendime operative duke cenuar eficiencën, kufiri ndërmjet politikëbërjes dhe menaxhimit operacional dhe në Këshillin Mbikëqyrës duhet të ketë dhe përfaqësues nga pushtetit vendor;

Të përcaktohen mekanizmat e matjes së performancës;

Neni 17, të përcaktohen frekuenca të detyrueshme raportimi, të vendosen standarde të aksesit publik (open data), si dhe mekanizmat e monitorimit nga publiku;

Neni 18, pika 3/a, të qartësohet dhe të specifikohet se ku konsiston;

Të specifikohet me qartë si dhe të ndalohet ndërhyrja direkte e ministrisë në operacione ditore:

- funksionin politik (Ministria);
- funksionin strategjik (Këshilli);
- funksionin ekzekutiv (Administratori).

Të ndryshohet përbërja e Këshillit Mbikëqyrës duke përfshirë:

- 2 anëtarë nga ministritë (Mjedisi dhe bujqesia);
- 1 përfaqësues i pushtetit vendor;
- 1 ekspert i pavarur (pyje);

- 1 anëtar nga shoqëria civile/academia.

Të shtohet një nen që detyron hartimin e indikatorëve në lidhje me sistemin e performancës:

- bilanci kadastral pozitiv (më shumë rritje pyjesh se sa pakësim);
- % e sipërfaqes së ripyllëzuar në vit;
- ulja e zjarreve në pyje;
- menaxhimi i sëmudjeve dhe dëmtuesëve;
- rritja e biodiversitetit;
- të ardhura për hektar pa degradim të burimeve pyjore.

Të shtohet një dispozitë që vendos prioritet absolut ruajtjen e qëndrueshme mjedisore mbi fitimin financiar, ku të përcaktohen:

- kufij të shfrytëzimit vjetor (sipas planeve ekologjike);
- auditim mjedisor i detyrueshëm;
- zbatim i standardeve të BE-se (EUDR, FLEGT, EIONET etj).

Të detyrohet SHSHP për:

- konsultim me bashkitë për planet e menaxhimit;
- përfshirje e tyre në vendimmarrje territoriale;
- perfaqësim të interesit të komuniteteve locale.

4. Për projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të përcaktohet një ndarje se cilat të dhëna do të gjenden nga bashkitë dhe cilat nga Ministria përkatëse.

5. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 179 datë 26.2.2020 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992” “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore””, i ndryshuar, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.

6. Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të qartësohet çfarë nënkupton roli kordinues i prefektit lidhur me policinë bashkiake, ndërkohë në pr/ligjin për policinë bashkiake parashikohet që prefekti kordinon bashkëpunimin e policisë bashkiake me institucionet qendrore në nivel vendor;

Në Nenin 14/1. “Kordinimi me organet qendrore” propozojmë të hiqet pika 2 “Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për

çështjet dhe problematikat në nivel vendor” pasi kordimini me njësitë vendore është trajtuar në nenet 15 e në vazhdim të ligjit aktual.

7. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 203, datë 10.4.2019 e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagë””, propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të parashikohet një mbështetje nga buxheti i shtetit specifike për mbulimin e kostove që rrjedhin nga ky projektligj.

8. Për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016, “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””, propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

Të ndryshohen emërtimet e gradave në fjalë, edhe në VKM-në 895/2016, me qëllim përshtatjen e tyre me ndryshimet ligjore. Për këtë arsye, pika 1, e projektvendimit në fjalë parashikon se në pikën nr. 3 dhe lidhjen nr. 2, të VKM-së 895/2016, kemi zëvendësime të disa fjalëve që lidhen me ndryshime të disa gradave të nivelit të mesëm;

9. Për projektligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të përcaktohen në mënyrë të detajuar burimet financiare shtesë apo mekanizmat e mbështetjes për bashkitë. Kjo mund të krijojë vështirësi, sidomos për njësitë vendore me kapacitete të kufizuara financiare dhe administrative ndërkohë projektligji shton kërkesa konkrete për standarde aksesueshmërie, monitorim dhe investime dhe ligji të jetë më specifik dhe të përmbajë më shumë detyrime konkrete si dhe të përcaktohet nëse do të rregullohet aksesueshmëria në shërbime dhe infrastrukturë publike me një ligj të veçantë apo do të mbulohet po nga ky ligj;

Neni 17 “Ndryshimet thelbësore dhe barra joproporcionale” parashikon se detyrimet për aksesueshmërinë nuk zbatohen kur vendosin një barrë financiare joproporcionale për operatorin ekonomik. Të përcaktohet se si do të llogaritet barra joproporcionale në këtë rast ngaqë ky nen parashikon vetëm një vetvlerësim të operatorit ekonomik por jo një miratim nga strukturat përgjegjëse;

Në Nenin 22 “Financimi i aksesueshmërisë” pika 2 parashikohet që bashkitë do të planifikojnë fonde për financimin e mënjanimin të pengesave mjedisore dhe infrastrukturore

në ofrimin e shërbimeve publike. Të parashikohet një mbështetje financiare dhe teknike e dedikuar nga buxheti i shtetit për të asistuar bashkitë ti përgjigjen detyrimeve të këtij ligj në mënyrë sa më efikase veçanërisht për bashkitë e mesme dhe të vogla;

Neni 23 “Përbërja e Këshillit Kombëtar” parashikon që Këshilli të ketë 17 antarë ndërkohë që përmenden 15 (ministri, personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat). Të përcaktohet në ligj cilët janë 2 anëtarët e tjerë të tij;

Neni 31 “Përputhshmëria e shërbimeve”, të përcaktohet cila është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e aksesueshmërisë së shërbimeve në Republikën e Shqipërisë;

10. Për dokumentin “Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2026-2030”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të minimizohet hendeku midis kuadrit ligjor dhe zbatimit praktik;

Të qartësohet roli i bashkive për monitorimin dhe inspektimin e heqjes së barrierave në infrastrukturë;

Të rritet qëndrueshmëria financiare e shërbimeve përmes forcimit të mekanizmave të financimit, përfshirë edhe krijimin e Fondit Social Vendor; Të formalizohet gritja e një strukture monitoruese në nivel kombëtar, pranë Këshillit të Ministrave, e cila do të mbikëqyrë zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në mjedise, shërbime dhe produkte ku të përfshihen në këtë strukturë e organizatave për personat me aftësi të kufizuara;

Të përcaktohet përgjegjësia e NJQV për ofrimin e shërbimit transporti “derë më derë” për personat me aftësi të kufizuara që kanë kufizime të rënda lëvizjeje;

Të krijohet një protokoll për stafet e NJQV që do merren me rastet e personave me aftësi të kufizuara;

Të përcaktohet që në masat për sigurimin e transportit falas për personat me aftësi të kufizuara të përfshihen në transportin falas dhe kujdestarët;

Sugjerohet që ndihma juridike falas të ishte një shërbim vendor, i organizuar me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë por i menaxhuar në vazhdimësi nga bashkitë;

11. Për dokumentin “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve 2026-2030”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Objektimi III.1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë në varësi infermierët dhe mediatorët e shëndetit, për pasojë nuk mund të jenë insitucion përgjegjës, por mund të jenë institucione partnere për të lehtësuar procesin;

Objektivi IV.1 Sugjerohet që aktivitviteti të riformulohet: “Përjashtimi për tarifat e regjistrimit dhe frekuentimit të cerdhes dhe kopshteve për fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane” Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë në varësi mediatorët e caktuar nga institucionet

arsimore vendore të parashikuara nga VKM-ja 511, datë 27.07.2022, për pasojë nuk mund të jenë institucion përgjegjës, por mund të aísistojnë si partner për të lehtësuar procesin;

Përcaktimi i kriterëve për bursat e nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm, përcaktohen nga Vendimi I Këshillit të Ministrave nr. 666 dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore e kanë të vështirë për të qënë institucione përgjegjëse në realizimin e këtij aktiviteti;

Objektiv V.2. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore mund të ofrojnë grante start up ose fuqizim të bizneseve të vogla për kategorinë e të rinjve dhe vajzave dhe grave duke vendosur si kategori prioritare pakicat rome dhe egjiptiane, por nuk mund të hapë një program vetëm për pakicat. Sa i përket hartimit të planeve të biznesit dhe monitorimit të tyre Bashkia ofron asistencë teknike me ekspert për asistimin e individëve të përzgjedhur nga komisioni si potencial për të menaxhuar grantin e vetëpunësimit;

Sugjerohet riformulimi i aktivitetit duke mos krijuar kuota specifike, por vendosjen e e pakicave rome dhe egjiptiane si kategori prioritare përfituese të hapësirave tregtare;

Objektiv VII.2 Pranë strukturave të vetëqeverisjes vendore nuk ka një strukturë që punon për ndërgjegjësimin ligjorë, për pasoj sugjerojmë që institucion përgjegjës të mos jenë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

12. Për projektudhëzimin “Për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zonat publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore, peisazhi dhe procedura e përzgjedhjes së subjekteve”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

Të njoftohet zyrtarisht bashkia nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për vendimin final dhe listën e subjekteve të miratuara për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në këto zona si dhe të përcaktohet roli parësor i bashkisë në procesin e miratimit, duke dhënë miratimin paraprak si institucion administrues i drejtpërdrejtë

Të forcohet roli i bashkive i cili duhet të jetë më vendimtar në miratimin e lejeve të tilla për pronat kulturore nën administrimin e tyre dhe jo të ngelet vetëm në shprehjen e mendimit, ndaj lejet përkatëse të miratohen përfundimisht nga bashkitë për ato objekte që janë nën administrimin e tyre.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë